



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	04.04.2024
Për:	Znj. Arbëneshja Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	Z. Ardian Gjini , Kryetar i Komunës së Gjakovës
Nga:	Z. Shkumbin Kastrati, Drejtor i Infrastrukturës
Tema:	Raport për gjendjen e rrugëve Urbane në Komunën e Gjakovës

Kontrata e lidhur me dt. 03.08.2021 deri me dt.01.08.2024

**Titulli i Kontratës “Mirëmbajtja e autorrugëve urbane” Nr. identifikimi 632-19-072-211
pjesa e I-rë.**

Raporti për Gjendjen e Rrugëve Urbane në Komunën e Gjakovës

Moti: me reshje të borës kohë pas kohe dhe ngricave,
temperatura: (0 °C) - (-5 °C)

Viti 2023

Me datë **25.11.2023** pasi që temperaturat janë nën zero dhe lagështija e vogël është kontaktuar operatori ekonomik për pastrim të rrugëve Grupi i Operatorëve SH.Drini Company SH.P.K Berisha Com SH.P.K Ersan Mazreku Lam 2/1, Prizren për pastrimin e rrugëve në pjesët Urbane, vlera e planifikuar e kontratës për 3 vite është **240,000.00 €** (dyqind e katër dhjetë mijë euro).

Operatori ekonomik ka filluar me pastrimin nga bora dhe akulli plus hedhje të kripës në orët 18:00 h, ku temperaturat kanë qenë të ulta. Menaxheri i Kontratës dhe anëtarët e komisionit të kontratës kanë dalë në teren për të përcjellë situatën, ku kemi vërejtur se në zonat Urbane ishin në qarkullim katër mjete motorike për pastrimin nga bora dhe akulli plus hedhje të kripës në zonat e kryesore të Qytetit dhe në rrugët dytësore.

Me datën **26.11.2023** operatori ekonomik ka bërë hedhje të kripës aty ku ka pasur nevojë dhe gjithmonë me mbikëqyrje të anëtarëve të komisionit dhe menaxherit të kontratës nga ora 05:30

h të mëngjesit temperatura ka qenë (-4°C) e mëngjesit ku puna ka vazhduar dhe jemi takuar me operatorin me të cilin jemi akorduar që të vazhdoj vetëm me hedhje të kripës.

Me datën **27.11.2023** në ora 07:00 h në mëngjesin kësaj dite ku temperatura (- 5°C), Operatori Ekonomik ka vazhduar me hedhje të kripës në zonat urbane aty ku komunikacioni është më i dendur. Ndaj anëtarët e komisionit dhe Menaxheri ka ndalur për të parë nga afër punët që është duke i bërë operatori ekonomik.

Me datën **09.12.2023** në orët e hershme të mëngjesin e kësaj dite ku temperatura ishin shumë të ulëta në (-5°C) operatori ka vazhduar me punën gjithmonë në mbikëqyrjen e komisionit ku operatori ekonomik ka bërë vetëm me hedhje të kripës.

Me datën **11.12.2023** në orët e hershme të mëngjesin e kësaj dite ku temperatura ishin të ulëta në (-5°C) operatori ka vazhduar me punën gjithmonë në mbikëqyrjen e komisionit ku operatori ekonomik ka bërë vetëm me hedhje të kripës.

Viti 2024

Me datën **19.01.2024** në e mbrëmjes gjatë reshurave të borës Menaxheri i kontratës dhe Komisioni Mbikëqyrës ka urdhëruar që bëjë pastrim nga bora dhe akulli plus të hedhjes të kripës në të gjithë qytetin e Gjakovës.

Me datën **20.01.2024** në orët e hershme të mëngjesit pasi që temperaturat ishin të ulta Operatori ekonomik me urdhëresë nga Menaxheri i kontratës ka vazhduar me pastrim nga bora dhe akulli plus të hedhjes të kripës. Po ashtu në orët mbrëmjes ka vazhduar me hedhje të kripës në zonat e qytetit gjithmonë në mbikëqyrje të komisionit.


Me datën **21.01.2024** në ora 05:00 h në orët e hershme të mëngjesit ka vazhduar punën operatori ekonomik me pastrim nga bora dhe akulli plus të hedhjes të kripës në lokacione të ndryshme të qytetit. Gjithashtu në orët mbrëmjes ka vazhduar me hedhje të kripës në qytet, gjithmonë në mbikëqyrje të komisionit.



Me datën **22.01.2024** në ora 03:00 h në orët e hershme të mëngjesit ka vazhduar punën operatori ekonomik vetëm me hedhjes të kripës në lokacione të ndryshme të qytetit. Gjithashtu në orët mbrëmjes ka vazhduar vetëm me hedhje të kripës në zonat e qytetit gjithmonë në mbikëqyrje të komisionit.



Me datën **24.01.2024** në ora 03:00 h në orët e hershme të mëngjesit ka vazhduar punën operatori ekonomik vetëm me hedhjes të kripës në lokacione të ndryshme të qytetit. Gjithashtu në orët


mbrëmjes ka vazhduar vetëm me hedhje të kripës në zonat e qytetit gjithmonë në mbikëqyrje të komisionit.

Me datën **25.01.2024** në ora 06:00 h të mëngjesit operatori ekonomik ka vazhduar punën vetëm hedhjes të kripës në lokacione të ndryshme të qytetit.









Faleminderit